



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 85 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt. 21.06.2016, nenit 17 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dt.20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" të Statutit të Komunës së Prishtinës 01nr.110-391 dt.25.02.2010, dhe bazuar në kërkesën 05nr.350/02-169487/24 dt.24.12.2024, në emër të kërkuarit: Pronarit, Mefail Cakolli nga Prishtina, dhe Investitorit "Argo Group Kosova"sh.p.k. nga Graçanica, me certifikatë të biznesit ARBK 812216548, dhe me përfaqësues Sadudin Humolli nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – **Ndërtesa** me 2B+S+P+13, në kuadër të Bllokut urban "b-13", të Nëntërësisë "B-03", të Tërësisë hapësinore "B", të Planit Rregullues "Muhaxhirët" dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të vendosjes së çështjes administrative, në detyrë zyrtare, me datë 04.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

PEZULLIMI I PROCEDURËS TË KËRKESËS 05NR.350/02-169487/24 DT.24.12.2024, PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE PËR NDËRTESEN SHUMË BANESORE & AFARISTE – NDËRTESA ME 2B+S+P+13

I. Pezullohet procedura e vendosjes së çështjes administrative, sipas kërkesës 05nr.350/02-169487/24 dt.24.12.2024, në emër të kërkuarit: Pronarit, Mefail Cakolli nga Prishtina, dhe Investitorit "Argo Group Kosova"sh.p.k. nga Graçanica, me certifikatë të biznesit ARBK 812216548, dhe me përfaqësues Sadudin Humolli nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – **Ndërtesa** me 2B+S+P+13, në kuadër të Bllokut urban "b-13", të Nën tërësisë "B-03", të Tërësisë hapësinore "B", të Planit Rregullues "Muhaxhirët" dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht parcelës kadastrale nr.10012-5 ZK Prishtinë.

II. Pezullimi i procedurës së vendosjes së çështjes administrative nga paragrafi I. i këtij vendimi, do të zgjasë deri në eliminimin e rrethanave që kanë qar në marrjen e këtij vendimi për pezullimin të procedurës, përkatësisht deri në një vendim tjetër të organit gjyqësor, për heqjen e masës së sigurisë, të caktuar për parcelën kadastrale **nr.10012-5** ZK Prishtinë, të vendosur nga Gjykata Themelore në Prishtinë, sipas Aktvendimit C.nr.8853/2024 dt.30.01.2025 AKTV.IZ.K.K.Nr.11-016/01-0030029/25 dt.03.03.2025.

A r s y e t i m

Kërkuarit: Pronari, Mefail Cakolli nga Prishtina, dhe Investitori "Argo Group Kosova"sh.p.k. nga Graçanica, me certifikatë të biznesit ARBK 812216548, dhe me përfaqësues Sadudin Humolli nga Prishtina, me kërkesën kanë kërkuar nga kjo drejtori, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – **Ndërtesa** me 2B+S+P+13, në lokacionin e përshkruar si në paragrafin I. të këtij vendimi.

Në fazën e finalizimit të kërkesës së lartcekur, dhe pas verifikimit të sistemit të evidentimit të Agjencionit Kadastral të Kosovës, është konstatuar se bazuar në Aktvendimin C.nr.8853/2024 dt.30.01.2025 AKTV.IZ.K.K.Nr.11-016/01-0030029/25 dt.03.03.2025, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për parcelën kadastrale nr.10012-5 ZK Prishtinë, është vendosur masë e sigurisë, dhe kjo drejtori nuk mund të vazhdojë procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore, sipas kërkesës në trajtim.

Andaj, Drejtoria e Urbanizimit, bazuar në konstatimet e lartcekura dhe duke u mbështet në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht në nenin 85 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, vendosi që, deri në eliminimin e rrethanave që kanë qar në pezullimin e procedurës së çështjes administrative, përkatësisht deri në nxjerrjen e një vendimi

tjetër të gjykatës, kërkesën për caktim të kushteve ndërtimore 05nr.350/02-169487/24 dt.24.12.2024, ta pezullojë me këtë vendim.

Bazuar në konstatimin e lartcekur, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet, apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

I dërgohet: Kërkuesit/investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosjen e lëndës, 05nr.350/02-169487/24 dt.24.12.2024.

Përmes postës elektronike: Të njoftohet avokati Xhafer Tahiri, sipas autorizimit, në emailin: xhafer@gmail.com.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.350/02 – 169487/24 DT.04.03.2025,**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini

Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi

